# Manuali i përdorimit

**Nëntor, 2025**

This document is produced with the financial support of the European Union (EU) and Federal Ministry of Economic Cooperation and Development (BMZ), through co-funded action on “Administrative Burden Reduction”, implemented by the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH as part of the BMZ Technical Cooperation Module “Support of EU-Integration Reform Processes in Kosovo”.

The views expressed in the document are of the contractor and do not reflect in any way or form the official position of the European Union, Germany and GIZ.

Ky dokument është zhvilluar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian (BE) dhe Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik (BMZ), përmes komponentës së bashkëfinancuar për "Reduktimin e Barrës Administrative", e zbatuar nga "Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH" moduli teknik "Mbështetje për Reformat e Procesit të Integrimit Evropian”.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të kontraktorit dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Bashkimit Europian, Gjermanisë apo GIZ-it.

## Përmbajtja

Hyrje ........ 3
Qëllimi i Manualit ........ 3
Organizimi i Materialit ........ 4
Baza Ligjore dhe Teknike ........ 4
Për Kë Është Manuali ........ 4
Si të Përdoret Manuali ........ 5
Ndihmë për të bërë ofertë në Ankandin e Siguruar ........ 6
Ndihmë për të bërë ofertë në Ankandin Standard ........ 13
Ndihmë për të bërë ankesë për ofertë ........ 16
Krijo Ankesë. ........ 16

**Historia e revidimit**

| Versioni | Data | Përshkrimi |
|---|---|---|
| V0.9 | 19.11.2025 | Dokumenti i parë i dërguar tek GIZ |
| V1.0 | 01.12.2025 | Dokumentimi i plotë |

**Shkurtesat**

AASPK - Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AI – Inteligjencë Artificiale
CSV – Comma-Separated Values (format për importimin e të dhënave të pasurive)
eID – Identitet Elektronik i Republikës së Kosovës
eKosova – Platforma qeveritare për shërbime online dhe identifikim të qytetarëve
OAP – Online Auction Platform (Platforma e Ankandeve Online)
PDF – Portable Document Format (format për kontrata dhe dokumente të gjeneruara)
PO – Purchase Order (Faturë/urdhër-pagesë i krijuar nga sistemi)
SMTP – Simple Mail Transfer Protocol (për dërgimin e email-ve nga sistemi)
UI – User Interface (Ndërfaqja e përdoruesit)
UX – User Experience (Përvoja e përdoruesit)
ZIP – Format arkivimi për dokumente të ngarkuara (kur aplikohet)

# Hyrje

Ky seksion i manualit paraqet mënyrën e përdorimit të Portalit të Ankandeve Online të Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) i referuar edhe si sistemi ballor i ankandeve. Portali është zhvilluar në kuadër të procesit të digjitalizimit të ankandeve, me mbështetjen e projektit “Support to EU-Integration Reform Processes in Kosovo”, me qëllim që proceset e shitjes dhe dhënies me qira të pasurive të sekuestruara të jenë më transparenta, më të shpejta dhe më të qasshme për qytetarët dhe bizneset.

Portali ofron dy lloje ankandesh – Ankandi i Siguruar dhe Ankandi Standard – dhe u mundëson përdoruesve të bëjnë oferta si individë ose si kompani, varësisht rregullave të secilit ankand. Ankandi i siguruar mundëson ofertimin përmes ofertës së mbyllur ndërkaq ankandi standard është ankand që ofron mundësinë e ofertimit të shumëfishtë dhe ku shihet oferta më e lartë aktuale. Përmes ndërfaqes së thjeshtë dhe të strukturuar, përdoruesit mund të shohin listën e pasurive, të lexojnë detajet për secilën pasuri, të vendosin ofertat, si dhe të kryejnë pagesat e depozitave kur kërkohet.

Sistemi është ndërtuar duke respektuar kërkesat funksionale dhe jo-funksionale të përcaktuara në Termat e Referencës dhe kërkesat e AAPSK-së të dala gjatë zhvillimit të sistemit.

Ky manual udhëzon përdoruesit për secilin hap të procesit të ofertimit – nga shikimi i pasurive, vendosja e ofertës, pagesa e depozitimit për ankandet e siguruara, deri te regjistrimi i ankesave për ofertat. Për administratën e AAPSK-së, manuali shërben gjithashtu si referencë për menaxhimin e sistemit dhe vlerësimin e kërkesave të përdoruesve.

# Qëllimi i Manualit

Qëllimi i këtij manuali është të sigurojë një udhëzues të qartë, praktik dhe gjithëpërfshirës për përdorimin e Portalit të Ankandeve Online të AAPSK. Manuali synon të:

- shpjegojë mënyrën e funksionimit të portalit, nga shfletimi i ankandeve deri te realizimi i ofertave dhe kryerja e pagesave;
- sqarojë dallimet ndërmjet Ankandit të Siguruar dhe Ankandit Standard;
- ofrojë instruksione hap-pas-hapi për përdoruesit që konkurrojnë si individë ose si kompani;
- mbështesë përdoruesit e huaj për t’u regjistruar dhe verifikuar sipas procedurave të parashikuara;
- udhëzojë përdoruesit për menaxhimin e ankesave, verifikimin e statusit të ofertave dhe shikimin e historikut të transaksioneve.

Ky dokument gjithashtu shërben si referencë zyrtare që siguron një përdorim të saktë të sistemit në përputhje me procedurat, afatet dhe kërkesat operative të përcaktuara nga Agjencia.

# Organizimi i Materialit

Manuali është strukturuar në mënyrë logjike, duke e ndarë materialin sipas rrjedhës së natyrshme të përdorimit të sistemit:

1. Hyrja dhe prezantimi i sistemit – shpjegon rolin dhe funksionet e portalit.
2. Përdorimi i portalit nga individët – përshkrim i plotë i hapave të ofertimit në Ankand të Siguruar dhe Standard.
3. Përdorimi i portalit nga kompanitë – procedurat e ofertimit dhe pagesës së depozitës.
4. Regjistrimi dhe verifikimi i përdoruesve të huaj – procesi i aplikimit dhe aprovimit nga back-office.
5. Historia e ofertave, ankesat dhe komunikimi – mënyra e menaxhimit të ankesave dhe verifikimit të veprimeve.
6. Shembuj ilustrues dhe pamje të ekranit – për orientim vizual të përdoruesve.

Kjo ndarje e bën manualin të lehtë për navigim dhe mundëson gjetjen e shpejtë të instruksioneve për çdo funksion të portalit.

# Baza Ligjore dhe Teknike

Manuali është hartuar në përputhje me bazën ligjore dhe teknike që e rregullon procesin e administrimit, shitjes dhe dhënies me qira të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Kjo kornizë ligjore dhe teknike siguron që portali të jetë i sigurt, transparent dhe plotësisht i harmonizuar me procedurat zyrtare.

# Për Kë Është Manuali

Manuali është përgatitur për disa kategori përdoruesish:

Përdoruesit e jashtëm (bidders)

- Qytetarët vendorë që hyjnë përmes eKosova/eID.
- Bizneset vendore që aplikojnë si kompani.
- Përdoruesit e huaj (individë ose kompani) që kërkojnë qasje në portal pas verifikimit nga Agjencia.

Manuali shërben si dokument praktik si për përdoruesit përfundimtarë, ashtu edhe për stafin që administron sistemin.

# Si të Përdoret Manuali

Për të përfituar maksimalisht nga ky manual, përdoruesit duhet:

- Ta lexojnë seksionin e duhur sipas rolit të tyre (individ, kompani, përdorues i huaj).
- Të ndjekin hapat e ilustruar në tekst dhe imazhe, të cilat mbështeten në pamje reale të portalit.
- Të përdorin manualin si referencë sa herë që hasin vështirësi në:
  - vendosjen e ofertës,
  - ngarkimin e faturës së depozitës,
  - monitorimin e statusit të ofertave,
  - ngritjen e ankesave.

Manuali është konceptuar që të përdoret si “udhëzues praktik” gjatë përdorimit të përditshëm të portalit, duke ndihmuar përdoruesit të shmangin gabime dhe të kryejnë proceset në përputhje me rregullat e ankandeve online.

# Ndihmë për të bërë ofertë në Ankandin e Siguruar

Në Ankandin e Siguruar mund të bëni vetëm nga një ofertë për pasuri si Individ ose me Kompaninë përkatëse.

**Ndiqni këto hapa për të bërë ofertë për pasuri pa depozit si individ:**

1. Këtu keni listën e ankandeve dhe pasuritë për ankandet përkatëse. Për të shikuar detajet për një pasuri të caktuar klikoni **Detajet**.



Këtu mund të shihni detajet e pasurisë, të shkruani ofertën tuaj dhe të ofertoni si individ




Pas përfundimit të ofertimit, shfaqet një konfirmim që njofton se oferta është regjistruar me sukses.



Ndiqni këto hapa për të bërë ofertë për pasuri me depozit si kompani:

2. Këtu keni listën e ankandeve dhe pasuritë për ankandet përkatëse. Për të shikuar detajet për një pasuri të caktuar klikoni **Detajet**.




Këtu mund të shihni detajet e pasurisë, në qoftë se ka depozitë së pari duhet të paguani depozitën. Për të paguar depozitën si Kompani klikoni **Kompani**.



Këtu zgjidhni mënyrën e pagesës.




Psh. Zgjedhim **Faturë**, menjëherë do të shkarkohet fatura.




Pas shkarkimit të faturës, ju mund të bëni pagesën e saj dhe ta ngarkoni dëshminë përkatëse të pagesës. Kjo bëhet si në vijim.

Nga menyja përkatëse, tek lista e blerjeve tuaja, gjeni faturën përkatëse dhe pasi që keni bërë pagesën e depozitës sipas faturës klikoni **Detajet** tek fatura përkatëse.




| Nr. Serik Konfiskuar | Nr. Serik Sekuestruar | Emri i Ankandit | Emri i Pasurisë | Lloji i Faturës | Mënyra e page... | Shuma e page... | Emri i kompan... | Verifikuar | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 000553 | - | AAPSK – 015/2025 | Produkte ushqimore, pije, mallra | Depozitë | Fature | 811.10 | | Jo | DETAJET |
| - | 000179 | Test Live Hapur | Audi A6 | Depozitë | Online | 1,500.00 | Hood Morrow Associates | Po | DETAJET |
| 000552 | - | AAPSK – 015/2025 | Produkte ushqimore, pije, mallra | Depozitë | Online | 811.10 | Dodson and Hodges Plc | Po | DETAJET |
| 000552 | - | AAPSK – 015/2025 | Produkte ushqimore, pije, mallra | Depozitë | Online | 811.10 | Hood Morrow Associates | Po | DETAJET |
| 000551 | - | AAPSK – 015/2025 | Produkte ushqimore, pije, mallra | Depozitë | Online | 811.10 | GCT | Po | DETAJET |
| 000551 | - | AAPSK – 015/2025 | Produkte ushqimore, pije, mallra | Depozitë | Online | 811.10 | | Po | DETAJET |
| 000550 | - | AAPSK – 015/2025 | Produkte ushqimore, pije, mallra | Depozitë | Fature | 811.10 | | Jo | DETAJET |
| 000550 | - | AAPSK – 015/2025 | Produkte ushqimore, pije, mallra | Depozitë | Fature | 811.10 | GCT | Jo | DETAJET |
| - | 000178 | Test Live Hapur | Audi A6 | Depozitë | Online | 1,500.00 | Hood Morrow | Po | DETAJET |

Këto janë detajet e faturës.



Zvarritni poshtë ku ju duhet të ngarkoni dëshminë e pagesës dhe të klikoni **Ngarko Faturën.**




Pasi që pagesa të verifikohet ju mund të shkoni tek pasuria dhe të shihni se keni kryer pagesën e depozitës si kompani dhe nëse ndiqni të njëjtit hapa mund ta kryeni edhe si individ. Këtu i shihni informatat nëse keni paguar depozitën si individ apo me ndonjë kompani.



Tani ju mund të ofertoni si individ ose me ndonjë kompani me të cilën keni paguar depozitën duke zgjedhur në listë.




Këtu shkruani ofertën tuaj.



Për të dërguar ofertën klikoni **Oferto**.




# Ndihmë për të bërë ofertë në Ankandin Standard

Në Ankandin Standard mund të bëni më shumë se një ofertë për pasuri si Individ ose me Kompani përkatëse me ose pa depozit.

1. Këtu mund të shikoni detajet e pasurisë, te shkruani oferten tuaj,dhe ju mund të ofertoni si individ



Pas përfundimit të ofertimit, shfaqet një konfirmim që njofton se oferta është regjistruar me sukses.



Në Ankandin Standard, ju mund të vendosni më shumë se një ofertë për një pasuri, qoftë si individ apo përmes kompanisë përkatëse, me ose pa depozitë.

Për të shikuar detajet e pasurisë dhe për të paguar depozitën ju lutem ndiqni hapat si për ankandin e siguruar.

Këtu mund të shihni numrin e ofertave momentale, oferta që jepni duhet të jetë më e lartë se oferta e fundit + Hapi rritës i ofertës (këtë çmim e merr automatikisht nëse doni ofertë tjetër duhet të jetë më e lartë se ajo).



Këtu mund të shkruani ofertën tuaj dhe ta dërgoni duke klikuar **Oferto**.




# Ndihmë për të bërë ankesë për ofertë

1. Tek Ofertat ju mund të shihni të gjitha ofertat që keni bërë. Për të bërë ankesë klikoni **Krijo Ankesë.**




| Emri i Ankandit | Emri i Pasurise | Lloji i Ankandit | Emri i kompanise | Çmimi | Data e Krijimit | Actions |
|---|---|---|---|---|---|---|
| AAPSK – 015/2025 | Produkte ushqimore, pije, mallra | Ankand Standard | GCT | 8,211.00 | 17.11.2025 12:43 | KRIJO ANKESË |
| AAPSK – 015/2025 | Produkte ushqimore, pije, mallra | Ankand Standard | | 8,111.00 | 17.11.2025 12:33 | KRIJO ANKESË |
| AAPSK – 015/2025 | Produkte ushqimore, pije, mallra | Ankand i siguruar | | 10,000.00 | 17.11.2025 12:23 | |
| | | | | 0.00 | 17.11.2025 01:00 | |
| | | | | 0.00 | 17.11.2025 00:51 | |
| | | | | 0.00 | 17.11.2025 00:51 | |
| | | | | 0.00 | 17.11.2025 00:51 | |
| | | | | 0.00 | 17.11.2025 00:50 | |
| | | | | 0.00 | 17.11.2025 00:50 | |
| | | | | 0.00 | 17.11.2025 00:49 | |
| Test Live Hapur | Audi A6 | Ankand Standard | | 15,800.36 | 14.11.2025 09:38 | KRIJO ANKESË |
| AAPSK – 015/2025 | Vilë model 'A' P+1 | Ankand Standard | | 7,842.00 | 12.11.2025 09:59 | KRIJO ANKESË |
| Test Live Hapur | Audi A7 3.0 | Ankand Standard | | 19,000.80 | 11.11.2025 12:21 | KRIJO ANKESË |
| Test Live Hapur | Audi A7 3.0 | Ankand Standard | | 18,800.80 | 11.11.2025 12:20 | |
| Test Live Mbyllur | Audi A7 3.0 | Ankand i siguruar | Corporis incidunt m | 30,000.00 | 11.11.2025 12:04 | KRIJO ANKESË |
| Test Live Mbyllur | Audi A7 3.0 | Ankand i siguruar | GCT | 17,000.03 | 11.11.2025 11:38 | KRIJO ANKESË |
| Test Live Mbyllur | Audi A7 3.0 | Ankand i siguruar | | 17,000.01 | 11.11.2025 11:37 | KRIJO ANKESË |

Shkruani ankesën tuaj tek Përshkrimi dhe ngarkoni foto nëse keni. Për të dërguar ankesën klikoni **Ruaj**.

